



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina



### E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 21.11.2022,  
duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri dhe Bahri Gashi.

**Mungoi:** Mirsad Vitia.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Valbona Ahmeti - Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bujar Çunaku, përfaqësues nga Drejtoria e Pronës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Adelina Sahiti, drejtoare e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fehmi Kupina, kryesues.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Milazim Vitija** propozoi që në rend të ditës të futet pika "Shfuqizimi i Rregullores për taksën në transaksion".

Me propozimin e dhënë, kryesuesi konstataoi se u miratua ky

#### Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria";
3. Propozimvendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës;
4. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;

Faqe 1 nga 7

5. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", sipas kërkesës së rektorit të UP-së në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme në vitin 2023;
7. Propozimvendimi për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit;
8. Propozimvendimi për përkrahje financiare viktimate të dhunës në familje;
9. Propozimvendimi për miratimin e Rregullores për auto-taksi;
10. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022/2023;
11. Shfuqizimi i Rregullores për taksën në transaksion;
12. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatai se njëzéri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Pika e dytë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria".

Lidhur me Propozimvendimin për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Mimoza Sylejmani, drejtore.

**Gëzim Sveçla** ngriti shqetësim rreh këtij propozimplani, duke thënë se është një çështje që ka mundur të bëhet shumë më herët dhe tanj kjo veç po fillon, kështu që qytetarëve u është premtuar që në muajin shtator apo në tetor do t'u jepen lejet për ndërtim, e në fakt kjo nuk ka ndodhur. Me këtë praktikë që është duke vazhduar edhe në vitin 2023 lagja "Kalabria" e ka të humbur këtë plan.

**Leutrim Retkoceri** tha se është mirë që iniciohet ky plan dhe duhet me kaluar përmes Kuvendit. Lidhur me këtë plan, ai kërkoi të dijë se a mundet me u bërë inicimi i Planit të hollësishëm pa PZHK -në.

Lidhur me pyetjet e parashtruar nga parafolësit, sqarime shtesë dha Mimoza Sylejmani, drejtore.

Kryesuesi konstatai se u miratua Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

## Pika e tretë

### Propozimvendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës.

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

**Gëzim Sveçla** ngriti shqetësim rreth ndarjes së këtyre subvencioneve, konkretisht për Federatën e Xhudos, duke thënë se ajo është e nivelit nacional, kështu që më e arsyeshme do të ishte që të subvencionohen klubet e xhudos së Prishtinës. Po ashtu, tha se sa i përket ndarjes së druve për djegie, më mirë do të ishte që të bëhet përmes procedurave të tenderimit.

**Bahri Gashi** tha se me rastin e subvecionimit të familjeve të cilat kanë pësuar dëme nga fatkeqësitet natyrore, konkretisht në këtë rast ceket një familje që ka pësuar dëme materiale nga zjarri, duhet të kemi kujdes se kemi edhe dëme të tjera të cilat janë shkaktuar nga vërshimet, kështu që duhet pasur parasysh të ndihmohen edhe ato familje.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e katërt

**Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.**

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Bersant Beka, drejtor.

**Bahri Gashi** tha se grupet politike kanë të drejtë me e deleguar përfaqësuesin e vet, kështu që unë e delejoi përfaqësuesin dhe nuk mundet askush mua me ma përcaktuar përfaqësuesin as me ma caktua kuotën. Ne si subjekt jemi pro barazisë gjinore dhe punojmë për këtë punë dhe do të vazhdojmë deri në fund, por me barazi gjinore vetëm si kuotë ne nuk dëshirojmë me u marrë me atë, sepse ai është ofendim dhe është pozitë e keqe për gjithë gjininë femërore. Përfaqësimi i AAK-së nuk bazohet as në kuotë as në standardet e juaja, ato bazohen në punë, përkushtim dhe vullnetarizëm. Në këtë komision, përfaqësuesi i AAK-së është i gjinisë mashkulllore, kështu që ekzekutivi për interesat e veta, për nevojat e veta e ka obligim me e plotësua kuotën.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", sipas kërkesës së rektorit të UP-së në Prishtinë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, arsyetimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës e paraqiti Bujar Çunaku, përfaqësues nga Drejtoria e Pronës.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", sipas kërkesës së rektorit të UP-së në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

## Pika e gjashtë

Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme në vitin 2023.

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore, e cila tha se nga Ministria e Financave kemi marrë një vlerësim rrëth rritjes së çmimeve, sidomos në disa zona ku kanë shkuar deri në 400%, kështu që ne e kemi konsideruar se janë çmime shumë të ngritura.

**Gëzim Sveçla** pyeti se cila është puna jonë, çka ne mundemi me bërë lidhur me rritje e këtyre çmimeve. Mendoj se ne as që kemi me i rivotuar këto tarifa që i ka caktuar Ministria, ndërsa normat e Kuvendit i votojmë. Sipas Ligjit për tatimin në pronë, nëse Kuvendi komunal nuk përcakton në kohë (pra koha është 30 nëntori) normën tatimore, Ministria e Financave aplikon normën e fundit tatimore, do të thotë se mbesin normat e vitit të kaluar, por në shifra të reja, vlera të reja.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se nuk mundet niveli qendror me e vendosur një ligj, një ministri me vendosur për fatin e të gjitha komunave. Secila komunë e ka kuvendin komunale që voton në për dhënien e pronave në shfrytëzim, që votojnë për këmbimin e pronave, për planet rregulluese, për rregulloret, pse duhet me qenë ne nëse nuk votojmë për taksën që është esencialja e raportit mes qytetarit dhe shtetit. Si GP do të kërkojmë që kjo pikë të mos vije si pikë e rendit të ditës, sepse ne duhet ta shtyjmë, nuk duhet ta bëjmë miratimin e asaj që bie në kurrizin e qytetarëve drejtëpërdrejt.

**Bahri Gashi** shprehu mendimin se ndoshta ekzekutivi duhet të ndërmarrë hapa, të bëjë ankesë, apo të bëhet një grup punues që me i përcjellë vërejtjet dhe ankesat lidhur me këto norma tatimore.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme në vitin 2023 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## **Pika e shtatë**

### **Propozimvendimi për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit.**

Lidhur me Propozimvendimin për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të kryeqytetit, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

**Gëzim Sveçla** falënderoi drejtorin për prezantimin e kësaj pike, duke thënë se themelimi i kësaj poliklinike është interes i përgjithshëm i qytetit, Lidhur me këtë kërkoi të dijë se tash klinika aktuale që është aty te stadiumi, do të mbetet aty apo jo.

Për pyetjet e parashtruar nga parafolësit Izet Sadiku, drejtor, dha sqarime të nevojshme.

**Milazim Vitia**, e përgëzoi drejtorin për marrjen e kësaj iniciative, njëkohësisht edhe për marrjen e iniciative të tjera, siç është ajo për Spitalin e Prishtinës, kështu që ne i përgëzojmë të gjithë ata që punojnë për të mirën e kryeqytetit.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## **Pika e tetë**

### **Propozimvendimi për përkrahje financiare viktimate të dhunës në familje.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, arsyetimin rreth përkrahjes financiare viktimate të dhunës në familje e paraqiti Adelina Sahiti, drejtore.

**Gëzim Sveçla** e falënderoi drejtoren për punën që po e bën, jo vetëm me këtë rast, por me të gjitha punët që kanë të bëjnë me çështje të përkrahjes financiare për kategorinë e caktuara që jetojnë në kryeqytet.

**Nora Kelmendi** tha se subvencionimi i mjeteve për jetesë, prej 150 euro, mendoj se është shumë e pamjaftueshme dhe do të ishte mirë që kjo të jetë 200 euro.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se kjo është një iniciativë shumë e mirë e ndihmës dhe e falënderojmë drejtoren për punën që ka bërë, kështu që si GP këtë propozimvendim për përkrahje financiare e përkrahim.

**Bahri Gashi** tha se shuma e këtyre mjeteve financiare që janë të përcaktuara për përkrahje, nuk janë të mjaftueshme, kështu që do të ishte mirë që ato të rriten.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, sqarime shtesë dha Adelina Sahiti, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për përkrahje financiare viktimate të dhunës në familje, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e nëntë

### Propozimvendimi për miratimin e Rregullores për auto-taksi.

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin Rregullores për auto-taksi, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Ilirik Musliu, drejtor.

**Bahri Gashi** ngriti shqetësim rreth miratimit të Rregullores për auto-taksi, duke thënë se, krahasuar me rregulloren paraprake, kjo rregullore ka bërë ndryshim drastike, kështu që do të jetë një kosto e papërballueshme e taksistëve individuale për pajisje me vetura që nuk janë më shumë se tetë vjet të vjetra.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se është e vërtetë që kjo rregullore e parashih edhe moshën e veturave dhe kur është mendua kjo pjesë, është menduar edhe çështja e sigurisë, çështja e ndotjes së ajrit, çështja e performancës së atyre kompanive, sepse vetura më e mirë i ofron punë më të mirë atij nëse vetëm është duke u marrë me atë kategori të biznesit. Mendoj se duhet pasur standard dhe ai standard nuk i dëmton, sepse ngritja e çmimeve dhe investimi në biznesin e tyre kthehet në përfitim pikërisht të atyre që punojnë me këtë kategori.

**Gëzim Sveçla** tha se sipas rregullores shihet hapja e tregut të kompanive të takstive, a ka nevojë Prishtina ende për taksi dhe sa ka me ndikuar kjo në Planin e mobilitetit. Po ashtu, edhe numri i shtuar i veturave taksi në një kohë ku ne po tentojmë me e zvogëlua numrin me variacione të ndryshme, sa ndikon në zbatimin e mobilitetit në kryeqytet. Cilat janë sfidat kryesore për aplikimin e kësaj rregulloreje?

**Milazim Vitia** tha se është folur shumë për deponinë e materieve të ngurta dhe nuk e di deri ku ka kaluar kjo procedurë e deponisë, për shkak se ato deponi i hasim nëpër pjesë jashtë Prishtinës, sidomos pjesa e Hajvalisë, ku janë të démtuara të gjitha pusetat dhe rrugët për shkak të transportit të tyre.

Lidhur me vërejtjet dh sugjerimet e dhëna, sqarime shtesë dha Ilirik Musliu, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Rregullores për auto-taksi dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e dhjetë

### Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022/2023.

**Kryesuesi** tha se në mungesë të drejtores së Drejtorisë së Arsimit, kjo pikë e rendit të ditës mbetet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.

## Pika e njëmbëdhjetë

### Shfuqizimi i Rregullores për transaksion.

**Milazim Vitia** tha se për shfuqizimin e kësaj rregulloreje kemi biseduar me drejtoritë përkatës edhe me kryetarin e Komunës, andaj propozojmë që kjo taksë të shfrytëzohet për 1 vit, të jetë si fazë eksperimentale dhe pas 1 viti do të bëhet rregullorja e re.

Faqe6nga7

**Gëzim Sveçla** tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim, kështu që ne si GP e kemi iniciuar më parë këtë propozimvendim e që nuk ka kaluar me votën e dyfishtë të kryesuesit, por pa marrë parasysh kush është propozuesi, për vendimet që janë në të mirë të qytetarëve dhe i shërbejnë mirëqenies së qytetarëve, ne e shprehim përkrahjen tonë.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah shfuqizimi i Rregullores për transaksion dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e dymbëdhjetë**

**Të ndryshme**

**Kryesuesi** tha se propozimi i z. Sveçla ka qenë që, pikat "Pjetje dhe përgjigje" dhe "Të ndryshme" të jenë pika e dytë në rend të ditës, kështu që ai propozim nuk ka kaluar. Unë propozoj që këto dy pika të fuzionohen në një pikë, derisa të hartojmë një Rregullore të re për punën e Kuvendit. Po ashtu, kërkoj që seanca e Kuvendit të jetë vetëm deri në orën 16:00, ose të përfundojë deri në këtë kohë, për disa arsyet.

**Gëzim Sveçla** theksoi se propozimi i kryesuesit përfundon e dy pikave në një pikë, si dhe koha e kufizimit të mbajtës së mbledhjes nuk qëndron, pasi që mendoj se kufizimi kohor i seancës as nuk parashihet me ligj, dhe mendoj se e dëmon ton substancën, i dëmon ton vendimet, dhe konsideroj se penalizohen asamblistët.

Lidhur me këtë, ai propozoi që shefat e grupeve parlamentare, apo qoftë të gjithë së bashku, me e mbajtur një mbledhje që nuk ka të bëjë me seancën dhe me filluar me i pëershruar veprimet të cilat ne duhet ndërmarrë që në funksion të seancës, por edhe në funksion të përgjithshëm të punës së Kuvendit komunal.

**Jeta Rafuna** propozoi që të jetë një punëtori një ose dy ditore, për me filluar me procedurën rrëth ndryshimit të Rregullores së Kuvendit, ku besoj se ka shumë gjëra që duhet ndryshuar.

**Leutrim Retkoceri**, sa i përket propozimit të kryesuesit që seanca të paktën të përfundojë në orën 16:00, ne e përkrahim këtë propozim, mirëpo ne duhet dhënë njëfarë qëllimi edhe kohor mbarëvajtjes së seancës, që ajo mos të shkojë në pafundësi.

Ne duhem ta hartojmë një rregullore, mirëpo para se me shkuar te ajo rregullore, duhet me i njobur pak praktikat se si shkojnë, qoftë çështjen e pauzës, qoftë çështjen e pyetjeve dhe përgjigjeve, të ndryshmeve, pra duhet me i pasur disa modalitetë që e ndryshon dhe me provuar se a po funksionon apo nuk po funksionon.

**Bahri Gashi** u shpreh i pajtimit me propozimin e kryesuesit përfundon e dy pikave në një pikë të vetme, por që anëtarët e Kuvendit me e pasur dyfishin e kohës së diskutimit, ndërsa sa i përket propozimit që mbledhja me përfunduar në orën 16:00 nuk qëndron, jam kundër këtij propozimi. Lidhur me këtë, ai shtoi se në seancë të gjithë ne përpinqemi me diskutuar diçka, me rregulluar diçka, kështu që ai debat shkon gjatë. Gjithashtu, drejtoret e drejtive duhet t'i sjellin pika me kohë, por nëse i sjellin më vonë mos të pranohen ato.

*Mbledhja përfundoi në orën 12:30.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

Faqe 7 nga 7

**Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina**

